



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA KOMERCIALE
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

K.DH.SH.II.nr.976/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Dren Rogova, kryetar i kolegjit, Ramush Bardiqi dhe Faton Bajrami, anëtarë të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Ardi” ShPK me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, me bazë juridike anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.946/20, të datës 14.07.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 07.09.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si bazuar ankesa e paditësit “Ardi” ShPK me seli në Prishtinë, **PRISHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.946/20, i datës 14.07.2021 dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me Aktgjykimin e ankimuar e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit-subjektit, “Ardi” ShPK me seli në Prishtinë, ka lënë në fuqi aktvendimin nr. 01.3.2.2/2525 të datës 16.03.2020 të Doganës së Kosovës në Prishtinë.

Kundër këtij aktgjykimi, paditësi ka bërë ankesë, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, duke i propozuar gjykatës që të marr aktgjykim duke aprovuar si të bazuar ankesën e paditëses “Ardi” ShPK me seli në Prishtinë dhe duke anuluar në tërësi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti Administrativ, Divizioni Fiskal, A.nr.946/20, i datës 14.07.2021 sipas të cilit aktgjykim është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit dhe është lënë në fuqi Aktvendimi i Doganës së Kosovës nr.01.3.2.2/2525 datë 16.03.2020 sipas të cilit vendim është refuzuar si e kërkesa e paditësit për rishqyrtimin e vendimit kontestues dhe të kthehet lënda përsëri në rishqyrtim dhe rivendosje pranë Gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata Komeriale - Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e Aktgjykimit të kontestuar si në vështrim të nenit 49 të LKA-së, nenit 81.h të Ligjit për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurën nr.03/L-222, dhe nenit 194 i LPK-së, (ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA-së), në drejtim të theksimeve në ankesë, përgjigjes në ankesë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

- Ankesa është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktvendimin e të paditurës Dogana e Kosovës, nr.01.3.2.2/2525 të datës 16.03.2020, është refuzuar kërkesa e subjektit në procedurë “Ardi” SH.P.K me seli në Prishtinë për rishqyrtimin e vendimit nr. R-439/15.01.2020 të ZBD Prishtina 3 si e pa bazuar.

Kundër aktvendimit të paditurës, subjekti në procedurë administrative - paditësi, në gjykatën e shkallës së parë ka iniciuar konfliktin administrativ. Gjykata e shkallës së parë, ka marr aktgjykimin e ankimuar me të cilin e refuzon kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit. Sipas konkludimeve të gjykatës së shkallës së parë në arsyetim është theksuar se gjykata nuk ka mundur të vërtetoj një gjendje tjetër faktike nga gjendja të cilën e ka konstatuar organi i paditur gjatë procedimit administrativ, për arsye se as në këtë konflikt administrativ paditësi nuk ka qenë në gjendje që gjykatës t’ia dëshmoj provat për të vërtetuar se vlera e mallit lëndor është vlera e vërtetë e transaksionit e paguar për mallrat e shituar për eksport në Kosovë, siç parashihet me dispozitat e nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave nr.03/L-109. Përkundrejt pretendimeve të paditësit në padi i cili thekson se mallin lëndor e kanë përcjell të gjitha dokumentet e nevojshme të cilat kërkojnë për vendosje të mallit në qarkullim të lirë, gjykata konstaton se dokumentacioni për mallin lëndor i paraqitur në procedurën administrative dhe në këtë konflikt administrativ është i pamjaftueshëm për të konstatuar se vërtet paditësi ka paraqit vlerën reale të mallit lëndor.

Bazën juridike për vensojen sipas aktgjykimit, gjykata e shkallës së parë e mbështetë në atë se për të pranuar vlerën e transaksionit sipas metodës së parë të vlerësimit neni 33 të Kodit doganor dhe të Akcizave të Kosovës 03/L-109, në këtë rast paditësi është dashur të dëshmoj vlerën e vërtetë të transaksionit të cilën ia ka paguar shitësit – eksportuesit të mallit lëndor. Më tej gjykata ka theksuar se, edhe pse pala paditëse i ka prezantuar gjykatës provat materiale si Deklaratën Unike Doganore R-439/15.01.2020 të ZBD Prishtina 3, faturën e mallit doganor nr.1-182 të datës 06.01.2020 mirëpo nuk ka arritur të dëshmojë pagesën e mallit lëndor si dëshmi se është paguar vlera e deklaruar e mallit doganor sipas faturës përcjellëse të mallit doganor e datës 06.01.2020.

Dhomat e Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes dhe pas ekzaminimit të aktgjykimit të ankimuar, dhe shkresave të tjera të lëndës, e duke pasur parasysh edhe pretendimet ankimore, gjen se aktgjykimi i kontestuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të

procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 të LPK pika nën n) e cila përcakton se: *“në qoftë se aktgjykimi ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohen, e sidomos në qoftë se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm apo kontradiktor me vetvete ose me arsyet e aktgjykimit, apo nëse aktgjykimi nuk ka fare arsye apo në të nuk janë treguar fare arsye për faktet vendimtare, ose ato arsye janë të paqarta, ose kontradiktore, ose nëse për faktet vendimtare ekzistojnë kundërthënie midis asaj që në arsyet e aktgjykimit thuhet për përmbajtje të dokumentit ose të procesverbalit për thëniet e dhëna në procedurë dhe të vet atyre dokumenteve ose të procesverbalit”*.

Kolegji i kësaj gjykate vlerëson se në procedurë gjyqësore të konfliktit administrativ shqyrtohet dhe vlerësohet ligjshmëria e një akti administrativ përfundimtar, sipas dispozitave ligjore të LKA-së, LPK-së dhe ligjeve materiale. Në rastin konkret, gjykata e shkallës së parë ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit pa e vërtetuar në tërësi gjendjen faktike të dokumentacionit përcjellës që e ka shoqëruar DUD kontestues R-439/15.01.2020 të ZBD Prishtina 3. Kolegji i kësaj gjykate konstaton se nga provat e administruara për DUD-in kontestues, paditësi ka paraqitur faturën me nr. 1-182 të datës 06.01.2020, transaksionin bankar të paraqitura nga paditësi i datës 21.01.2020 e që është realizuar me euro, në bankën TEB në vlerë prej 14,420.00€, në të cilën është përshkruar numri i faturës së paguar të mallit lëndor kontestues nr.1-182 të datës 06.01.2020 e cila faturë ndërlihet me DUD-in kontestues R-439/15.01.2020.

Kolegji i kësaj gjykate pasi ka analizuar transaksionin bankar dhe faturën e mallit lëndor kontestues, konstaton se transferi bankar është bërë në emër dhe llogari të eksportuesit të mallit “MIKE COMPANY”, ku përmes të dhënave bankare të eksportuesit të paraqitura në faturë është bërë edhe transferi bankar i datës 21.01.2020, ndërsa në përshkrimin e transferit është shënuar *“pagesa e faturës invoice nr.1-171/1-177/1-182 me nr. të DUD-ave R-2890/R-11235/R-439 që përmbajnë Lighter - shkrepca xhepi”*. Sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së dytë, nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës rrjedh se në këtë transfer bankar përcaktohen edhe detajet e faturave për DUD-at jo kontestues e të cilat gjenden në shkresat e lëndës e të cilat harmonizohen me këtë transaksionin bankar të datës 21.01.2020.

Sipas vlerësimit të Kolegjit, pretendimet e të paditurës se dokumentacioni përcjellës i mallit është i pa mjaftueshëm pasi që kontrata e shitblerjes mungon, kjo Gjykatë vlerëson se kontrata e shitblerjes nuk është dokument i cili kërkohet sipas Kodit Doganor dhe Akcizave të Kosovës dhe nuk është dokument i obligueshëm, mirëpo për gjykatën e shkallës së parë mjafton që të harmonizohen faturat e DUD-ave kontestues me trasnaksionet e pagesave.

Dhomat e Shkallës së Dytë kanë shqyrtuar pretendimet ankimore dhe tani për tani gjejnë se qëndrojnë pretendimet se transferi bankar përmban numrin identifikues të mallit që gjendet i shënuar në faturën përcjellëse të mallit, dhe ky transfer bazuar në të dhënat nuk ka mungesë të harmonizimit në kuptim të shumës ashtu edhe në kuptim të përshkrimit me faturën e mallit lëndor

kontestues. Andaj, Kolegji vlerëson se përpos vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, aktgjykimi i atakuar është përfshirë edhe me zbatim të gabuar të drejtës materiale pasi që gjykata e shkallës së parë në mënyrë të gabuar ka konstatuar se e paditura e ka zbatuar drejtë nenin 35 përkatësisht metodën e 6 të vlerësimit sipas KDA-së, pasi që nga faktet e çështjes rezulton se paditësi ka poseduar dokumentet e transaksionit të harmonizuara në kuptim të vlerës dhe se nga e paditura nuk është prezantuar asnjë provë e cila do të dëshmonte se paditësi ka paguar më shumë se fatura në emër të mallit.

Prandaj, kjo gjykatë tani për tani nuk mund të pranoj si të drejtë një konstatim të tillë të paraqitur në aktgjykimin e ankimuar, sepse ka të meta për të cilat nuk mund të ekzaminohet, dhe se është juridikisht i paqartë dhe i paqëndrueshëm.

Për arsyet e lartcekura, aktgjykimi i kundërshtuar është dashtë të anulohet dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim, për t'i eliminuar shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore të theksuara më lartë, që janë të tilla që pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së aktgjykimit të kontestuar.

Gjykata e shkallës së parë, në ri procedurë, duhet të bëjë vlerësimin e ligjshmërisë së aktvendimit kontestues me nr.01.3.2.2/2525 të datës 16.03.2020, vendim i marrë nga e paditura, e që është objekt shqyrtimi në këtë çështje juridike. Gjykata e shkallës së parë duhet t'i mënjanoj të metat e cekura me lartë, duke vepruar sipas rregullave procedurale kontestimore, t'i vërtetoj faktet relevante dhe provat që lidhen me pretendimet e paraqitura në ankesë, të vlerësoj dhe analizoj të gjitha provat e nevojshme konform nenit 7 dhe 8 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, që janë me rëndësi për vendosjen e rastit konkret. Pas vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike dhe mënjanimin të shkeljeve esenciale të lartpërmendura, gjykata e shkallës së parë ka mundësi të bie aktgjykim të drejtë dhe të ligjshëm në kuptim të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II.nr.976/22, me datë 07.09.2023

Kryetari i kolegjit, gjyqtari
Dren Rogova